


Don Alfred Sokoli

10/07/2017



Sh. Nr.	54/4
Da.	28. 05. 2017
Dr.	

Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria -Vlada-Government

Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit -Ministarstvo Kulture, Omladine i Sporta-
Ministry of Culture, Youth & Sports

Qendra Rajonale për Trashëgimi Kulturorë / Regionalni Centar za Kulturno Nasledje / Bölge
Kültürel Miras Merkezi / Regional Center for Cultural Heritage
Prizren

DATË/A:	05.05.2017
REFERENC-Ë:	Nr.54/4
PËR/ZA/TO:	Administrata Apostolike e Prizrenit
CC:	
PËRMES/PREKO/THROUGH:	
NGA/OD/FROM:	Samir Hoxha - Drejtor i QRTK-së Prizren
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Vendimi i Komisionit të IKMM-së Prishtinë

Po ju dërgojmë Vendimin e Komisionit të IKMM-së për Shqyrtimin dhe Vlerësimin e Kërkesave dhe Projekteve Restauruese-Konservuese të Trashëgimisë Kulturorë nr.22/2017 të dt. 26.04.2017 për Projektin e Restaurimit të Pikturave Murale të Katedralës "Zonja Ndhimëtare".

Lëndës ia bashkangjesim kopjen e Vendimit.



207 04.05.2017

Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
Qeveria – Vlada – Government
Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit / Ministarstvo Kulture, Omladine i Sporta /
Ministry of Culture, Youth and Sports

Instituti i Kosovës për Mbrojtjen e Monumenteve
Kosovo Institute for the Protection of Monuments
Institut Kosova za zaštitu spomenika

Nr. 22/2017
Datë: 26.04.2017

U.D. Drejtori i Institutit të Kosovës për Mbrojtjen e Monumenteve z. Agim Gërguri duke u mbështetur në nenin 3 (paragrafi, 4, 8), në nenin 4 (paragrafët 14, 17, 19 dhe 20) nenin 6 (paragrafët 3, 4, 5, 7 dhe 8), nenin 12 (paragrafi 2) të Ligjit Nr. 02/L – 88 për Trashëgiminë Kulturore, si dhe në zbatim të vendimit Ministrit të Kulturës, Rinisë dhe Sportit Nr. 18/2016 të datës 04.03.2016, mori këtë:

VENDIM

1. Aprovohet rekomandimi i Komisionit për Shqyrtimin dhe Vlerësimin e Kërkesave dhe Projekteve Restauruese dhe Konservuese të Trashëgimisë Kulturore të Institutit të Kosovës për Mbrojtjen e Monumenteve: “Miratimi i Projektit për Restaurimin e Pikturave Murale të Katedrales “Zonja Ndhimëtare” – Prizren..
2. Në bazë të rekomandimit të Komisionit, kërkohet që gjatë zbatimit, të respektohet projekti zbatues, i cili duhet të miratohet dhe miratohet në komision.
3. Zbatimi i punimeve sipas Ligjit të aprovuar bëhet nën mbikëqyrjen e një eksperti nga IKMM.
4. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Arsyetim

Kisha Katolike, Katedralja e Prizrenit, është në “Lista e Trashëgimisë Kulturore për Mbrojtje të Përkohshme” (10.10.2016 – 10.10.2017) me numër unik në databazë 000403 dhe daton që nga shekulli XIX, është një nga pasuritë e vyera të qytetit për nga rëndësia dhe vlerat unike historike, fetare e estetike. Vlerat e saj janë, njëkohësisht, një kartë identifikimi për autoktoninë e popullit që jeton në këtë vend, por edhe për mbarë popullin e Kosovës. Për këtë flasin studimet dhe zbulimet arkeologjike që janë nisur nga ne. Zbulimet tregojnë se kemi të bëjmë me themelet e një kishe paleokristiane që nga shekulli IV – V si dhe tjetra nga shekulli VIII – IX. Po ashtu edhe pikturat të cilat mbulojnë krejtë tavanet, atë të naosit qendror si dhe të dy anijatave anësore, përbëjnë një mozaik vlerash së bashku me stilin dhe ndërtimin e katedrales. Koha kur ato janë realizuar përkon me kohën e Lidhjes së Prizrenit me 1878 dhe janë të pikturuara nga piktorë austriakë. Përveç vlerave të larta që paraqesin, dekorimin e saj me figurat e rëndësishme të të shenjtërve, janë të pikturuara edhe dy figurat e strategëve të shquara të shekullit XV, simbole të luftës së popujve autoktonë kundër pushtimit osman në territorin e kontinentit evropian, Gjergj Kastrioti dhe Janosh Huniadi. Këto piktura janë të realizuara në faqen perëndimore të kishës. Fatkeqësisht, ky Monument me vlerë kaq të madhe kulturore dhe një objekt i rëndësishëm fetar, prej shumë kohësh dhe prej shumë arsyeve, që sot dihen, ka qenë lënë pas dore, duke sjellur dëmtimin e saj si në arkitekturë nga jashtë po ashtu edhe në interiorin e kishës. Piktura prej shumë kohësh, ka qenë në prani të shumë faktorëve shkatërrues e veçanërisht, të llojeve të ndryshëm të lagështisë në krijimin zinxhirë të sëmundjeve të ndryshme të shtresave të pikturës. Nga komisioni kërkohet vlerësimi i projekti për dhënien e pëlqimit për restaurimin e pikturave murale të Katedralës “Zonja Ndhimëtare”

Komisioni për Shqyrtimin dhe Vlerësimin e Kërkesave dhe Projekteve Restauruese – Konservuese të Trashëgimisë Kulturore / IKMM, pas shqyrtimit të lëndës, ka rekomanduar si në vijim:

1. Aprovohet Projekti për Restaurimin e Pikturave Murale të Katedralës “Zonja Ndhimëtare”
2. Njoftohet pala se implementimi i Projektit duhet të bëhet në mbikëqyrjen e IKMM

Vendimi i dërgohet:

- Kabinetit të Ministrit;
- Zyrës së Sekretarit të Përgjithshëm;
- Komisionit për Shqyrtimin e Kërkesave dhe Projekteve IKMM;
- Departamentit të Trashëgimisë Kulturore;
- QRTK – së përkatëse;
- Komunës përkatëse;
- Departamentit Ligjor – MKRS;
- Zyrës së Drejtorit të IKMM – së;
- Arkivit të IKMM – së;
- Arkivit të MKRS – së;

Agim Gërguri

U.D. Drejtor

